



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.168/2 prot.,

Datë 25.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89079-11-24-2023, me objekt “Blerje fruta dhe zarzavate” me fond limit 77,694,098.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane
- Ankimues:** “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK me NIPT K71804011J dhe adresë: Njësia Administrative Nr.12, rruga Nacionale e Dajtit, Zona Kdastrale Nr. 2460, Numer Pasurie 199/32-G1, Tirane
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane me adresë: Rr. “Barrikadave”, Tiranë

Në datën 24.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 168 prot., e “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89079-11-24-2023, me objekt “Blerje fruta dhe zarzavate” me fond limit 77,694,098.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, operatori ekonomik ERDIS shpk anëtar i bashkimit operator, në dokumentin e paraqitur në përmbushje të këtij kriteri, rezulton se xhirot vjetore të 2021 dhe 2022 të jenë disa herë më të vogla se përqindja e pjesëmarrjes së aktmarrëveshjes të BOE. Referuar VKM Nr. 285 , datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 88, pika 3 “...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje...”, për rrjedhojë BOE nuk e përmbush këtë kriter.”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 25.01.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri